



BASHKIA
TIRANË
REPUBLIKË E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK

VE N D I M

Nr. 128, datë 28.09.2020

“PËR

MIRATIMIN E RREGULLOREVE “PËR DETYRAT FUNKSIONALE TË STRUKTURAVE KOMUNITARE NË QYTET” DHE “PËR MIRATIMIN E DETYRAT DHE FUNKSIONIMIN E STRUKTURAVE KOMUNITARE NË FSHAT”

Mbështetur në nenin 54, shkronja “k”, nenin 55, pikat 2 dhe 6, nenin 68, nenin 69, nenin 70, dhe nenin 71 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjin nr.115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjin 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Vendimit nr. 33, datë 29.03. 2018, të Këshillit Bashkiak “Për krijimin e tre lagjeve në qytetin e Tiranës”; Vendimin nr. 38, datë 03.05.2019 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e nivelit të pagave të njësive administrative dhe lagjeve të Bashkisë Tiranë”, vendimin nr. 48492 datë 20.12.2019 të Kryetarit të Bashkisë “Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së aparatit të Bashkisë së Tiranës”, Urdhrin nr. 29662, datë 05.10.2016 të Kryetarit të Bashkisë “Për përcaktimin e listës së shërbimeve që u jepen qytetarëve nga njësitë administrative dhe/ose strukturat e aparatit të Bashkisë së Tiranës dhe ndarjes së detyrave në lidhje me to”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

V E N D O S I :

1. Miratimin e Rregullores “Për funksionimin e strukturave komunitare ne qytet sipas aneksit nr. 1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Miratimin e Rregullores “Për funksionimin e strukturave komunitare ne fshat sipas aneksit nr. 2 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik dhe Burimeve Njerëzore dhe të gjitha strukturat komunitare të Bashkisë së Tiranës në qytet dhe në fshat.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të Ligjit nr.139/2015, date 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

K R Y E T A R

TONI GOGU